

**Organisation for Security and Co-operation in Europe  
MISSION IN KOSOVO**

---

## **Strategjia për Drejtësinë**

Kjo strategji për drejtësinë thekson një qasje shumë-faqësore, për të adresuar sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet sistemi juridik penal. Është e njohur se në disa lami të diskutuara, iniciativat e tilla janë në shqyrtim e sipër. Sidoqoftë, procesi me të cilin ndryshimet legjislative, politike dhe procedurale janë bërë në sistemin juridik penal, nuk janë formalizuar apo bazuar në planifikimin afat-shkurtë apo afat-gjatë. Qasja e tanishme qështjeve në sistemin juridik penal pa përcjellje konkrete, e pengon shumë efektivitetin e iniciativave të cilat janë marrë, dhe që shpesh rezultojnë në dështimin të implementohet ndryshimi i mirëfilltë. Iniciativat për ndryshim shpesh janë të përcjellura në një nivel, duke dështuar të adresojnë aspektet tjera të domosdoshme, që ndryshimet dhe masat të jenë të suksesshme, duke maksimizuar përdorimin e burimeve të limituara.

Aty vazhdon të bëhet njohja se implementimi i sistemit juridik të drejtë dhe efektiv, është faktor kyq për suksesin e misionit të UNMIK-ut. Krijimi i një shtylle të re të institucionalizuar të policisë së UNMIK-ut dhe Departamentit Administrativ të Drejtësisë (DAD) bashkarisht, bëjnë të ditur nevojën për koordinimin e rritur, zhvillimin e rregullave dhe implementimin e gjithëmbarshtëm dhe efektiv të një strategjie për drejtësi. Duke zhvilluar një komunitet, ku sundimi i së drejtës dhe të drejtat e njeriut respektohen, kërkohet që ai legjislacion, praktikë e gjyqësisë dhe e policisë, si dhe politika e drejtësisë penale nuk duhet të jenë arbitrar por parashikues, transparent, konsistent dhe parimor. Ajo është, me këtë qasje gjithëpërfshirëse në mendje, rekomandim se çfarë hapash shumë-nivelor duhet të ndërmerren.

### **I. STRUKTURAT PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË AFAT-GJATE DHE KOHERENTE PËR DREJTËSINË**

Një trup koordinues në nivelet më të larta përbrenda UNMIK-ut, duhet të mbikqyr dhe udhëheq zhvillimin e rregullave të drejtësisë penale, legjislacionit dhe reformës për sigurimin e qasjes efektive dhe koherente qështjeve të drejtësisë penale.

Formalizimi i procesit dhe strukturave në fushat vijuese:

- Procesi i Kornizë-punës Legjislative
- Administrimi i drejtësisë dhe Policia Efektive: DAD dhe Policia e UNMIK-ut
- Komitetet Këshilluese mbi Sistemet e Përkrahjes Gjyqësisë dhe Ndërtimit të Kapaciteteve

- Përgjegjshmëria: Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës
- Rjedhshmëria kryesore e koordinimit dhe konsultimit me ekspertët vendor dhe akterët në sistemin e drejtësisë penale, përbrenda këtyre strukturave dhe proceseve.

## **II. TRUPI KOORDINUES MBI RREGULLAT, PËRGJEGJEN DHE ZHVILLIMIN: Grupi këshillues i Drejtësisë Penale**

Grupi këshillues i gjyqësisë penale (GKGJP), duhet të themelohet, i kryesuar nga ZPSSP për tu përgjigjur në rastet në shqyrtim sipas urdhërave ekzekutive, trendeve të përgjithshme dhe qështjeve politike dhe legjislative. Ky grup duhet të jetë drejtëpërdrejtë i lidhur me PSSP dhe të përbëhet nga personeli i kualifikuar i UNMIK-ut me përvojë nga drejtësia penale. Si e tillë, GPGJP duhet të përbëhet nga agjensitë parësore, zyrat dhe departamentet që kanë të bëjnë me qështjet e drejtësisë penale, Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut dhe Kryesuesit të DAD, OSBE - Të Drejtat e Njeriut dhe Sundimi i së Drejtës, Zyra e Këshilltarit Juridik (ZKJ) i PSSP dhe KFOR-i, se bashkarisht mund të ofrojnë një përgjegje koherente dhe të koordinuar dhe të zhvillojnë gjithëmbarshtëm sistemin e gjyqësisë.

### **A. Mbikqyrja dhe Udhëheqja**

GPGJP do të formalizon iniciativat e tanishme përkitazi me qështjet e gjyqësisë penale dhe do të takohet rregullisht për të shqyrtuar rregullaven dhe zhvillimet legjislative. Gjatë shqyrtimit të punës në fushat shumë-disciplinore të zhvillimit të gjyqësisë penale, GPGJP do të ftoj kryesuesit e agjencive relevante apo departamenteve për të pjesëmarrë në takim, siq është Kryesuesi i UNICEF-it, Kryesuesi i Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale apo Kryesuesi i UNHCR-it.

#### *i. Kornizë-puna Legjislative*

Procesi i formalizuar për shqyrtimin legjislativ i mbikqyrur nga GPGJP, do të siguroj që reforma legjislative të jetë koherente dhe efektive, që reforma e tillë të jetë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut dhe që ekspertët vendor të shqyrtojnë reformën në bazë të rregullave për zhvillimin e përkohshëm dhe afat-gjatë legjislativ.

#### *ii. Administrimi i Gjyqësisë dhe Policia Efektive*

Duke punuar nën strukturën e re të konsoliduar të GPGJP, detyrat e koordinuara të DAD dhe policisë së UNMIK-ut, përkitazi me sistemin e gjyqësisë penale do të zhvillohen. Kjo letër nënvizon rekomandimet për zhvillimin prioritar administrativ dhe operacional përbrenda agjencive relevante. GPGJP më tej do të siguroj që politika zhvillimore në sistemet përkrahëse gjyqësore dhe ndërtimi i kapaciteteve, si dhe reforma legjislative të implementohet përmes DAD dhe Policisë së UNMIK-ut.

#### *iii. Sistemet e Përkrahjes së Gjyqësisë dhe Ndërtimi i Kapaciteteve*

Puna e grupeve punuese *ad hoc*, forcat detyruese dhe komitetet mbi përgjegjen shumë-disciplinore dhe të koordinuar të qështjeve të gjyqësisë penale, do të formalizoheshin sipas nën-komiteteve nën mbikqyrjen dhe udhëheqjen e GPGJP. Këto trupa këshillues

sekondar, do të obligoheshin me formulimin e planeve punuese gjithëpërfshirëse për implementimin efektiv të ndryshimit legjislativ dhe politik. Nënkomitetet do të punonin rregullisht dhe për një kohë të gjatë, vazhdimisht duke zhvilluar rregullat dhe iniciativat e gjithashtu do të mund të ngrisin fondacionet dhe të tërhekin përkrahjen e donatorëve për projektet e veqanta apo iniciativat, për të adresuar lamitë që janë shqetësuese për ta. Kur aty ka zbrazëti në zhvillimin e përkrahjes së sistemit të gjyqësisë penale, GPGJP do të obligoj personelin nga UNMIK-u, dhe agencitë tjera që të formojnë nën-komitete.

## **B. Paraburgimet Ekzekutive**

GPGJP do të zhvilloj rregullat dhe procedurat, me të cilat një rast konsiderohet për paraburgim ekzekutiv, për të siguruar që ky organ është përdorur si zgjidhje e fundit kur të gjitha rrugët tjera gjyqësore janë shpenzuar, dhe kur të gjitha rastet për urdhërat ekzekutiv janë vlerësuar nën testin tri-faktorësh. Këto, në vijim janë rekomandimet për rregullat dhe procedurat për shpalljen e një urdhëri ekzekutiv për paraburgim:

- Për të siguruar transparencën e përdorimit të urdhërit ekzekutiv për paraburgim, GPGJP do të autorizoj publikimin dhe shpërndarjen e testit tre-faktorësh gjykatësve, prokurorëve dhe avokatëve.
- GPGJP vetvetiu duhet të bëjë përcaktimin se një rast substancialisht a e përmbush çdo kërkesë, sipas testit tre-dhëmbëzor. Vetëm rastet që përmbushin këtë test, do të konsiderohen për rekomandime për paraburgimin ekzekutiv nga PSSP. Prezenca e shumicës së gjykatësve ndërkombëtarë në rastin, duhet të shmangë çdo nevojë për urdhërin ekzekutiv, pasi që faktori i tretë do të mungoj.
- Urdhërat ekzekutive për të paraburgosur, duhet të ofrojnë bazën për vendim; që do të thotë se, ato duhet të veqojnë bazën sipas të cilës secili faktor nga testi është i përmbushur. Urdhërat e tilla për paraburgosje, duhet menjëherë ti dorëzohen të paraburgosurit dhe mbrojtësit të tij.
- Të gjitha urdhërat ekzekutive duhet automatikisht të jenë të shqyrtuara nga gjykata, në përbërje, ekskluzivisht nga, personeli ndërkombëtar gjyqësor në bazë të një kontestimi nga i paraburgosuri, në linjë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

## **C. Konsultimet dhe Kyqja Vendore**

GPGJP duhet rregullisht të diskutoj zhvillimet, iniciativat legjislative dhe politike, me autoritetet vendore në fushën e gjyqësisë penale. Posaqërisht, ajo duhet që rregullisht të takohet me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me Kryetarët e Gjykatave të Qarkut dhe me Krye-Prokurorët e Zyrave të Prokurorisë.

## **III. KORNIZË-PUNA LEGJISLATIVE: Standardizimi i Procesit Legjislativ të Proklamimit të Rregulloreve**

Të gjitha iniciativat legjislative, përkitazi me gjyqësinë penale duhet të mbikqyren nga GPGJP, gjatë projektimit dhe fazës së zhvillimit. Njëherë e projektuar, ato duhet të

përcillen përmes Komitetit Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit të Përbashkët Këshilldhënës mbi Qështjet Ligiore (KPK), i cili më vonë do të rishqyrtonte projektin në bazë të rregullave përkitazi me reformën e përkohshme dhe afat-gjate legislative. Njëherë të përkthyer, rregulloret e reja duhet ti jipen PSSP për shpallje, dhe GPGJP do të siguroj një mekanizëm efektiv për shpërndarje. Ky proces duhet të ekspedohet kur të paraqitet si e domosdoshme.

#### **A. Shqyrtimi i Formalizuar i Projekteve të Rregulloreve përkitazi me Gjyqësinë Penale**

Të gjitha nën-komitetet këshilldhënëse të GPGJP, Policisë së UNMIK-ut, ZQJ, dhe DAD duhet të obligohen që të informojnë GPGJP për reformën legislative, kornizë-kohën për reformë dhe planin për implementimin efektiv të ligjit të ri.

Të gjitha projekt rregulloret përkitazi me gjyqësinë penale, duhet të jenë të përcjellura nga një historiat legjislativ, që shpjegon objektin dhe qëllimin e ligjit dhe ofrimin e shpjegimit, në drejtim të ndikimit të ligjit të ri mbi ligjin e tanishëm të aplikueshëm, duke i përmendur nenet e ligjit, të cilat janë revokuar apo ndryshuar.

Të gjitha projektet e rregulloreve, duhet të jenë të përcjellura nga një plan i implementimit, i cili përfshin një listë të të gjitha direktivave administrative, rregullave dhe procedurave, qarkoreve gjyqësore dhe dokumenteve tjera të cilat janë të domosdoshme për implementimin efektiv të ligjit të ri.

#### **B. Komiteti Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut**

GPGJP do të distribuojë të gjitha projektet e rregulloreve, përkitazi me drejtësinë penale tek komponentat e UNMIK-ut për të drejtat e njeriut dhe agjencitë relevante të KB, për të siguruar që ligjet e reja janë në pajtueshmëri me standardet për të drejtat e njeriut.

Komponentat për të drejtat e njeriut pranë misionit të UNMIK-ut, përfshirë edhe Njësinë e të Drejtave të Njeriut dhe Punëve të Komunitetit pranë PSSP (DNJPK), Divizionit të të Drejtave të Njeriut pranë OSBE-së, Zyren e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ), Këshilltari për të Drejtat e Njeriut pranë Policisë së UNMIK-ut, Departamentin për Shoqërinë Civile dhe Qeverisjen e Mirë si dhe Këshillin e Evropës, do të formojnë Komitetin Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut (KSHDNJ), i cili do të obligohet me rishqyrtimin *ekspeditiv* të të gjitha projekteve të rregulloreve për pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut. KSHDNJ do të përpiloj një vërtetim për pajtueshmërinë me standardet për të drejtat e njeriut.

Pasiqë të formohet, projektet e tanishme të rregulloreve mbi Qasjen Mbrojtësit menjëherë do të jetë temë shqyrtimi nga Komiteti Shqyrtues mbi të Drejtat e Njeriut.

### **C. Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Qështjet Legjislative**

KPK do të pyetet mbi, dhe do të regjistroj përparimin e të gjitha iniciative për reformat legjislative përkitazi me drejtësinë penale. Kjo strukturë gjithashtu do të konsultohet para se projekti i rregullores të jetë finalizuar. KPK gjithashtu do të jep këshilla në fazën e hershme të pajtueshmërisë të çfarëdo rregulloreje të propozuar me projektin e ligjit penal dhe ligjit mbi procedurën penale.

KPK do të obligohet nga GPGJP që të krijoj një rregull të përdorimit të brendshëm të reformës legjislative, në formë të Rregulloreve ashtu që ti jep këshilla PSSP, mbi Rregulloret të cilat nevojitet të ndryshohen apo të anulohen, kur ligji penal apo ligji mbi procedurën penale të shpallen. Një rregullativë e tillë do të lejoj reformat legjislative për tani, që më shpejtë të referoj qështjet e veqanta, duke siguruar se ligji nuk është i duplikuar kur projektet e ligjeve të hyjnë në fuqi.

### **D. Përkthimi dhe Shpërndarja**

Rregulloret e reja do të kthehen PSSP për shpallje, vetëm kur ato të jenë përkthyer në të tri gjuhët zyrtare. Për sa i përket historiatit të bashkangjitur, nuk do të kërkohet që ato të jenë të përkthyer në datën e proklamimit. Por duhet, sidoqoftë, të bëhet përkthimi i gjithëmbarshtëm i historiateve të tilla atëherë kur Rregullorja të nënshkruhet.

GPGJP do të drejtoj revizionin e sistemit të tanishëm të shpërndarjes së Rregulloreve nga DAD, për të siguruar shpërndarjen e menjëhershme dhe të drejtëpërdrejtë të Rregulloreve të reja dhe historiateve të tyre për të gjithë gjykatësit e emëruar dhe prokurorët publik.

Për mbrojtësit, Qendra e Resurseve për Mbrojtësit Penal në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, duhet të obligohet që të siguroj shpërndarjen e menjëhershme të Rregulloreve të reja dhe historiateve të tyre për të gjithë mbrojtësit juridik që ushtrojnë profesionin.

## **IV. ADMINISTRIMI I DREJTËSISË DHE RREGULLAT EFEKTIVE**

Këto që vijojnë, janë rekomandimet për qëllimet prioritare administrative dhe operacionale për DAD dhe Policinë e UNMIK-ut, në strukturën e konsoliduar:

### **A. Emërimet dhe Pagesat**

Një ndërkombëtar duhet të emërohet pranë Zyres së Krye-Prokurorit të Kosovës të Gjykatës Supreme të Kosovës. Prokurori ndërkombëtar duhet të autorizohet të shqyrtoj të gjitha rastet e veprave penale të krimeve të luftës dhe atyre etnikisht të motivuara, dhe aktakuzat përkitazi me gjenocidin dhe, kur është e nevojshme, e njëjta duhet të ndryshohet apo të hedhet poshtë.

Gjykatës të caktuar duhet të emërohen brenda Gjykatave të Qarkut dhe atyre Komunale, si gjykatës penal familjar, të cilët do të kenë të bëjnë vetëm me rastet e dhunës familjare,

veprat seksuale në lidhje me familjen, abuzimin penal të fëmiut dhe pakujdesinë. Këto raste të rënda, kërkojnë gjykatës të cilët janë të ushtruar përkitazi me senzitivitetin e qështjes, sikurse gjykatësit për të mitur.

Kohëzgjatja e emërimit të gjykatësve ndërkombëtarë dhe prokurorëve, duhet të rritet në 12 muaj.

Duhet të bëhet rritja e pagesave për gjykatësit vendor dhe prokurorët publik, për ekspertët patolog mjeko-ligjor të Institutit Mjeko-Ligjor dhe për zyrtarët e SHPK.

## **B. Rregullat mbi Shpërndarjen Ndërkombëtare dhe Vendore të Punës dhe Rregullorja 2000/64**

Duhet të ekzistoj një zhvillim i qasjes koherente për shpërndarjen e punës në mes të gjykatësve ndërkombëtar dhe vendor dhe prokurorëve publik, që kyqin mënyrat e forcimit të raporteve të punës dhe kurtoazisë profesionale. Për shembull, përdorimi i ekipeve ndërkombëtare dhe vendore prokuroriale, do të jetë efektiv në ndërtimin e kapaciteteve të prokurorëve publik vendor, posaqërisht në rastet e rënda, siq është ndjekja e krimit të organizuar.

Duhet të bëhet formalizimi i menjëhershëm i kritereve, sipas të cilave janë shqyrtuar kërkesat nga *Rregullorja 64*. Këto kritere do të shpërndahen tek mbrojtësit juridik me ndihmën e Qendrës për Resurse Mbrojtëse Penale dhe Odës së Avokatëve të Kosovës. Këto kritere duket se do të shpërndahen drejtëpërdrejtë tek të gjithë gjykatësit dhe prokurorët publik.

Bashkangjitur me kriteret, duhet të bëhet shpjegimi përkitazi me arsyetimin dhe qëllimet prapa Rregullores 64, për të rritur kuptueshmërinë dhe bashkëpunimin në këtë qështje në mes të akterëve ndërkombëtar dhe vendor.

Duhet të bëhet një proces formal përmes të cilit Kryetarët e Gjykatave të Qarkut dhe gjykatësit relevant vendor dhe prokurorët publik, bëhen të vetëdijësuar mbi lejimin e kërkesës sipas *Rregullores 64*, apo përdorimit të *Rregullores 2001/02*.

Restriksioni në domenin e Rregullores 64, përkitazi me njoftimin se nuk aplikohet në gjykimet që tashmë kanë filluar, duhet të revidohet dhe largohet, në dritë të faktit se redukton efektivitetin dhe ndikimin në raste të caktuara.

### **C. Menagjimi i Rasteve në Gjykatat e Qarkut**

Procedura e shqyrtimit para-gjyqësor për të gjitha rastet e gjykatës së qarkut duhet të konstituohet. Kjo duhet të kyq emërimin e një asistenti menagjues të rasteve për të pesë gjykatat e qarkut, për të asistuar në caktimin e datave të gjykimit pranë gjykatave dhe shqyrtimit të dëgjimeve para-gjyqësore. Ky person do të caktohet edhe si person-kontakt për mbrojtësin.

Shqyrtimi i dëgjimeve para-gjyqësore, duhet të institucionalizohet dhe të mbahet përbrenda një periudhe të kufizuar pas aktakuzës. Në këto dëgjime, **kryetari i kolegjit** do të shqyrtoj rastin, me prokurorin publik dhe avokatin mbrojtës, për të identifikuar qështjet e jashtëzakonshme: sigurimin e mbrojtësit, gjatësinë e pritur të gjykimit, dëshmitarët e kërkuar, përfshirë edhe qështjet me shërbime të duhura si dhe identifikimin e qështjeve të jashtëzakonshme mjeko-ligjore dhe të tjera, që kërkojnë provë eksperte. **Prokurori publik/administratori gjyqësor** do të jetë përgjegjës për kontaktimin e zyrtarit policor ndërlidhës, para shqyrtimit të dëgjimit para-gjyqësor për të vërtetuar shërbimin e ftesave dhe sigurimin e dëshmitarëve. Nga Kryetarët e Gjykatave të Qarkut duhet të kërkohej që të sigurojnë që kryetarët e kolegjeve në rastet me aktakuza të mbajnë shqyrtimet e dëgjimeve para-gjyqësore, në bazë të rregullt.

### **D. Hetimet Penale**

Teknikat standarde të hetimeve policore, duhet të shkojnë në drejtim të themelimit të një programi për zyrtarët policor ndërkombëtar dhe vendor (SHPK) dhe të ekipeve penale hetuese të mështa ndërkombëtare dhe vendore.

Regrutimi i informuesve duhet të inicohet, me themelimin e rrjetë-punës së centralizuar për mbledhjen e informatave.

Zhvillimi i teknikave të pyetësorëve dhe fondacioni për pajisjet e domosdoshme, duhet të inicohet përfshirë edhe themelimin e kufizimeve të duhura dhe mbikqyrjen për të siguruar që përdorimi i teknikave të tilla është i ligjshëm dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare, përkritazi me drejtësinë penale.

Themelimi i një linje telefonike të nxehtë për krimet, duhet gjithashtu të bëhet bashkë me rritjen e kampanjës për vetëdijësimin publik dhe ngritjen e komunitetit përkritazi me masat anti-kriminalitetit.

### **V. SISTEMET PËRKRAHËSE: Nën-komitetet Këshillëdhënëse në Sistemet Përkrahëse të Drejtësisë dhe Ndërtimi i Kapaciteteve**

Nënkomitetet këshillëdhënëse të GPGJP, do të kishin për detyrë të referojnë në fushat e caktuara të rregullave të drejtësisë penale, të cilat kërkojnë një përgjigje të koordinuar dhe multi-disciplinare. Në këtë kornizë-pune, njësitë funksionale dhe administrative të DAD dhe Policia e UNMIK-ut, duhet të punojnë me komponentet tjera esenciale të UNMIK-ut, për zhvillimin e rregullave, ndryshimet legislative, Direktivat

Administrative, Memorandumet e Mirëkuptimit, Doracakët, rregullat dhe procedurat e brendshme, protokolet si dhe në sigurimin e implementimit efektiv të këtyre iniciativave.

Nga Nënkomitetet Këshillëdhënëse duhet të kërkohet, që ti ofrojnë GPGJP një plan punues gjithëpërfshirës, i cili do të përmbajë qëllimet afat-shkurta, afat-mesme dhe afat-gjata dhe të dalurat shumë-nivelore dhe raportimet, si indikatorë të përparimit në punë. Vonesa e tepërt eventuale mes nënkomiteteve, do të kërkojë një intervenim nga GPGJP.

Nënkomitetet duhet të jenë të obliguara të caktojnë mbledhje të rregullta me akterët relevant vendor, për të siguruar qëndrimet vendore në zhvillimin e iniciativave.

### **Nënkomitetet në Procedurën Penale dhe Përkrahja e Gjyqësisë**

***Pjesëmarrësit:*** DAD, Policia e UNMIK-ut, OSBE Sundimi Ligjor dhe ZKJ.

***Qëllimet:*** ekzaminimi i brendshëm i ndryshimeve legislative në Ligjin e Procedurës Penale (gjatë periudhës së reformave nga të KPK), qarkoret gjyqësore, përkrahja sistematike e nevojave të gjykatave, siq është procedura e shpërndarjes së thirrjeve në mënyrë efektive si dhe siguria e gjykatave, në mënyrë që të ngritet efektiviteti dhe procedurat e drejta.

#### ***Prioritetet:***

*E drejta për ta Kontestuar Paraburgimin*

Që të arrihen standardet themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe për të siguruar proklamimin e rregullës *habeas corpus*.

#### *Sigurimi i gjykimit të shpejtë*

Në procedurat ekspeduese ku dëshmitarët dhe viktimat janë në rrezik të ndikimit dhe/apo kërcënimit, lejohet që prokurori publik në rastet serioze penale të procedoj drejtëpërdrejtë aktakuzën, bazuar në hetimet e policisë, ashtu siq lejohet nga LPP RFJ, në rastet nga kompetenca e gjykatës komunale.

Një qarkore gjyqësore e cila interpreton Nenin 279 (2) LPP RFJ, duhet të shpërndahet, duke kërkuar nga gjykata që gjykimi të caktohet brenda dy muajve, nga dita kur është ngritur aktakuza. Vetëm i pandehuri ka të drejtë të heqë dorë nga kjo e drejtë, në qoftë se i nevojitet më tepër kohë për të pregaditur mbrojtjen e tij.

#### *Shqetësimet përkitazi me provat*

Të asistojnë në udhëheqjen e zhvillimit efektiv dhe të drejtë të rasteve, dhe të kufizojnë abuzimet e diskrecionit gjyqësor, konsideratë duhet ti kushtohet zhvillimit të udhëzimeve të duhura provuese që zgjërohen në rregullat provuese nga LPP RFJ.

#### *Hetimet e sakta dhe procesverbalet gjyqësore*

Derisa përmbledhja e dëshmive të përmirësohet, procesverbalet gjyqësore *verbatim* duhet të bëhen në të gjitha gjykimet penale dhe procedurat hetimore.



### *Udhëzimet Dënimore*

Vlerësimi i qasjeve dënimore dhe nevoja për udhëzimet për të asistuar në sjelljen e objektivitetit dhe pajtueshmërisë për dënimin, përfshirë edhe zhvillimin e Ligjit mbi Sankcionet Penale, që të përfshijnë rrethin e detajizuar dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

### **Nënkomiteti mbi Trajnimin Ligjor dhe Ndërtimin e Kapaciteteve**

**Pjesëmarrësit:** *SHSHPK, Trajnerët e Policisë së UNMIK-ut, Instituti Juridik i Kosovës, DAD dhe OSBE.*

**Qëllimi:** koordinimi i trajnimit dhe iniciativave të ndërtimit të kapaciteteve, sigurimi i pajtueshmërisë së trajnimit për policinë dhe gjykatat, dhe përgjegjia në iniciativat trajnuese në fushat e nevojshme të identifikuara dhe reformat legjislative.

#### ***Prioritetet:***

##### *Trajnimi si Parakusht*

Të gjithë gjykatësit dhe prokurorët, para se ata të supozojnë pozitat e tyre zyrtare, duhet të obligohen të pjesëmarrin trajnimin, si plotësim provimit profesional të judikaturës. Për gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurorët duhet gjithashtu të bëhet një trajnim i obligueshëm para-hyrës mbi ligjin e aplikueshëm vendor, dhe arsimimi i vazhdueshëm i obligueshëm ligjor mbi, në mes tjerash, KEDNJ.

##### *Arsimimi Ligjor i Vazhdueshëm*

Arsimimi i tillë duhet të jetë i obligueshëm për të gjithë gjykatësit, prokurorët publik dhe, në rastet e mbrojtësit juridik, kërkesë nga Oda. Fokusimi në arsimimin ligjor të vazhdueshëm duhet të jetë: projektimi ligjor; arsyetimi ligjor dhe përdorimi i provave për mbështetjen e vendimeve; marrja në pyetje e dëshmitarëve si një mjet për zhvillimin e provave; trajtimi i viktimave dhe dëshmitarëve të ndieshëm, posaqërisht viktimave të dhunës seksuale dhe ndër-familjare, në gjykatore. Programi i arsimimit të vazhdueshëm ligjor duhet të lehtësohet nga ekspertët dhe përdorimi i teknikave praktike mësimore, siq janë gjykimet trajnuese (imituese) dhe video-inqizimi.

##### *Zhvillimi Profesional*

Krijimi i mundësive të zhvillimit profesional, mund të përfshijë trajnimet e gjëra praktike për akterët e zgjedhur gjyqësor (përfshirë observimin e procedurave hetimore dhe gjykimeve) dhe mentorët gjyqësor për gjykatësit vendor dhe prokurorët publik kurdo që professionalistët me përvojë, mund të ofrojnë udhëzime të qarta mbi qështjet reale ashtu siq ato shtrohen në gjykatore.

##### *Gjykatësit porotë*

Një kurs trajnues themelor për gjykatësit porotë duhet të implementohet nga Instituti Juridik i Kosovës.

### *Trajnimi në fushat e specializuara*

Ekziston një nevojë e veçantë, për trajnim të koordinuar në fushat e specializuara, siq është përdorimi i mjekësisë ligjore në gjykata, dhuna seksuale, të miturit në konflikt me ligjin, dhuna familjare dhe abuzimi i fëmijëve. Në këto fusha, iniciativat trajnuese duhet të jenë të koordinuara dhe të integruara me Departamentin për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

### **Nënkomiteti mbi Mjekësinë Ligjore dhe Mjetet Hetimore**

***Pjesëmarrësit:*** Specialistët Mjeko-Ligjor të DAD, përfaqësuesit e Laboratoriumit Kriminalistik të Policisë së UNMIK-ut, përfaqësuesit e Institutit Mjeko-Ligjor, SHSHPK, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale dhe OSBE.

***Qëllimi:*** sigurimi i zhvillimit të koordinuar dhe të gjërë të shërbimeve mjeko-ligjore, përfshirë këtu edhe fushat e specializuara të mjekësisë ligjore, dhe mbledhja efektive dhe dobishmëria e provave mjeko-ligjore nga policia, gjykata dhe institucionet shëndetësore.

#### ***Prioritetet:***

##### *Njësiti i Vend-ngjarjes së Krimin serioz*

Njësiti i “Vend-ngjarjes së Krimin serioz”, përfshirë edhe patologët vendor mjeko-ligjor dhe zyrtarët e SHPK, duhet të zhvillohet si përgjegje e menjëhershme 24 orësh-e, ndaj rasteve penale serioze në tërë Kosovën.

##### *Pajisjet Mjeko-Ligjore*

Të gjitha stacionet policore të UNMIK-ut, duhet rregullisht të sigurohen me pajisjet mbledhëse të provave themelore, p. sh. për marrjen e shenjave të gishtërinjëve, marrjen e lëngjeve trupore, analizat e drogës etj.

##### *Provat Mjeko-Ligjore të Specializuara*

Një vend akomodimi duhet të themelohet në Institutin Mjeko-Ligjor për dhunën seksuale, bashkë me zhvillimin e protokoleve për mbledhjen dhe ruajtjen e provave në rastet e dhunës seksuale dhe abuzimit të fëmijëve. Elementet e dispozitave të dhunimit modern dhe e provave të sulmit në spitale dhe klinika, janë të domosdoshme për implementimin e protokoleve të tilla, përfshirë edhe trajnimin e personelit të specializuar për përdorimin e këtyre elementeve dhe për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës seksuale dhe abuzimit të fëmijëve.

### **Nënkomiteti për Viktimat dhe Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe Shërbimet Përkrahëse**

***Pjesëmarrësit:*** Policia e UNMIK-ut, DAD, Njësia e DNJPP PSSP, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, dhe OSBE.

***Qëllimet:*** të adresoj ndryshimet legjislative të cilat janë nën shqyrtim, të siguroj që nivelet e ndryshme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave dhe nevojave përkrahëse, janë efektivisht të implementuara dhe të financuara përfshirë edhe pajisjet e kërkuara, të krijoj vendbanim të sigurtë të duhur për dëshmitarët dhe viktimat dhe të zhvilloj

shërbimet përkrahëse për viktimën, që përfshin shërbimet psikologjike, sociale dhe referimet në asistencën ligjore.

### **Nënkomiteti mbi të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Abuzimi Penal i Fëmijëve dhe Pakujdesia**

*Pjesëmarrësit:* UNICEF, Njësia e DNJPP PSSP, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Departamenti i Rinisë/Edukimit, Menagjimi Penal i KB, Policia e UNMIK-ut, SHPK dhe OSBE.

*Qëllimet:* këshillat mbi legjislacionin dhe zhvillimi i legjislacionit, koordinimi ndërmjet agjencive dhe programet për preventimin e kriminalitetit të të miturve, implementimi i alternativave në paraburgimin e të miturve, dhe formulimi i rregullave dhe procedurave për përgjegjen e gjyqësisë ndaj abuzimit penal të fëmijëve dhe pakujdesisë.

### **Nënkomiteti mbi Veprat Seksuale dhe Dhunën Familjare**

*Pjesëmarrësit:* DAD, Policia e UNMIK-ut, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Departamenti i Rinisë/Edukimit, UNICEF/UNIFEM, SHPK dhe OSBE.

Qëllimet: këshillat mbi, dhe adresimi i gjyqësisë së koordinuar penale dhe përgjegja e shërbimit social ndaj dhunës kundër femrave, përfshirë dhunën familjare dhe veprat seksuale dhe formulimi i qasjes shumë-disciplinore për të luftuar rritjen e kriminalitetit seksual të të miturve/madhorëve të rinj.

### **Nënkomiteti mbi të Sëmurët Mental dhe të Burgosurit me Nevoja të Veqanta**

*Pjesëmarrësit:* Managjimi Penal i KB, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, OBSH, SHPK, dhe OSBE.

*Qëllimet:* këshillat mbi legjislacionin dhe mekanizmat për adresimin efektiv të qështjeve të të sëmurëve mental, dhe të burgosurve me nevoja të veqanta, përfshirë edhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale për sigurimin e trajtimit adekuat të të sëmurëve mental/nevojat e veqanta të të burgosurve dhe trajtimi efektiv i të sëmurëve dhe programi i rehabilitimit nga droga, për personat e dënuar për të pranuar trajtim të tillë si dhe rritja e kapaciteteve për të ardhurat adekuate të provave eksperte mbi qështjet e shëndetit mental.

### **Nënkomiteti mbi Rregullat e Krimit të Organizuar**

*Pjesëmarrësit:* Këshilltari Politik i PSSP, Policia UNMIK-ut, përfaqësuesit e Shtyllës së IV, SHPK, OSBE Departamenti i Sundimit Ligjor.

*Qëllimet:* të adresojnë nevojat për krijimin e rregullave shumë-faqësore mbi ndjekjet e krimit të organizuar, masat anti-korruptuese, sistemin legjislativ dhe të kontrollit të tatimeve, rregulloret strikte të transaksioneve punuese dhe financiare, dhe hulumtimin

dhe konfiskimin në kuptimin e legjislacionit, përkitazi me mbylljen e biznesit dhe humbjen e pasurisë.

### **Nënkomiteti mbi Minoritetet në Sistemin e Drejtësisë**

*Pjesëmarrësit:* OSBE, DAD, Policia e UNMI-ut, UNHCR, Njësia e DNJPP PSSP.

*Qëllimet:* këshillat mbi, mes tjerash, planin për përpjektjet e ripërtrira që të regrutohen gjykatësit minoritar dhe prokurorët publik, që të adresojnë qështjet e personelit gjyqësor minoritar, siq janë siguria dhe diskriminimi, dhe të sigurojnë që mekanizmat e drejtësisë penale të jenë të qasshme për komunitetin minoritar.

### **VI. PËRGJEGJSHMËRIA: Këshilli Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë së Kosovës**

Është rekomanduar që projektimi i Kodit të Etikës për gjykatësit dhe prokurorët publik të ekspedohet dhe që gjykatësit ndërkombëtar dhe prokurorët, të jenë subjekte të Kodit të njëjtë të Etikës, dispozitave disiplinore dhe atyre të largimit, sikurse edhe gjykatësit dhe prokurorët vendor.